



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

GRUPI I PUNËS

SPECIFIKIME TEKNIKE

***“FURNIZIMI PRANË PETROLIFERA ITALO ALBANESE (PIA) ME LËNDË DJEGËSE PËR
TERMOCENTRALET LUNDRUESE, VLORË”***

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. PËRSHKRIMI I NEVOJËS	5
3. LËNDA DJEGËSE DHE VENDODHJA E FURNIZIMIT.....	6
4. LIDHJA DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS	7
4.1. KUSHTET E SHËRBIMIT	8
5. QËLLIMI.....	10
6. OBJEKTI I PUNËS SË OPERATORIT EKONOMIK (OE) .. ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.	
6.1. KARAKTERISTIKAT E SHËRBIMIT.....	10
6.2. FORMA E OFRIMIT E KËRKUAR	10
7. PARASHIKIME TË TJERA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
8. DOKUMENTACIONI TEKNIK.....	11

1. HYRJE

Këto specifikime teknike përfshijnë kërkesat për blerjen e një sasive lëndë djegëse, që do të dorëzohet pranë PIA me qëllim furnizimin e TEC-ve Llundrues me adresë Triport, Vlorë, në përdorim të shoqërisë KESH sh.a.

2. PËRSHKRIMI I NEVOJËS

KESH është kompania më e madhe e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri, që operon hidrocentralet më të rëndësishme në vend dhe mbulon rreth 70-75% të kërkesës për konsum.

KESH është gjithashtu një furnizues i shërbimeve të sistemit për rrjetin shqiptar, si mbulimi i humbjeve nga rrjeti i transmetimit apo balancimi i energjisë.

Nëpërmjet VKM Nr. 757, datë 21 Dhjetor 2021, për “Disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021”, nëpërmjet të cilit Qeveria e Shqipërisë autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat dhe mundësitë që do të paraqiten, t’i drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë për kohësisht (1-2 vjet) me qira, asete gjeneruese termike shtesë, të cilat mund të instalohen dhe lidhen lehtësisht me Rrjetin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri.

Në bazë e për zbatim të këtij vendimi, shoqëria KESH sh.a, më datë 05.01.2022, ka publikuar në përputhje me parashikimet e VKM, Thirrje për Shprehje Interesi për marrjen me qira të një aseti gjenerues termik.

Në muajin Prill 2022, u nënshkrua mes palëve (Exelerate dhe Renco & KESH sh.a). Në muajin Shtator 2022, në zonën e Triportit, pranë Petroliferas, u vendosën për mirëmbajtje asetet lundruese.

KESH ka lidhur një kontratë depozitimi me Petrolifera Italo Albanese (PIA) për përdorimin e depozitave të tyre pranë zonës së Triportit.

Në këto kushte dhe në fazën kur asetet lundruese janë vendosur në vendin përfundimtar ku janë ankoruar me tokën, nga ana e shoqërisë bëhet e nevojshme furnizimi me lëndë djegëse i asetit.

Për këtë arsye, nga ana e shoqërisë evidentohet se për qëllime të furnizimit, nevoja për shërbimin që do të prokurohet është si më poshtë:

Blerja e një sasive lëndë djegëse dhe dorëzimi i saj pranë PIA.

Asetet lundruese kanë kapacitete të menaxhimit dhe ruajtjes së lëndës djegëse në një total prej rreth 1,000 (një mijë) ton lëndë djegëse. Konsumi i parashikuar i lëndës djegëse për 1 MWh është rreth 229 Kg që do të thotë se, në rastin e shfrytëzimit me kapacitet të plotë të impiantit, nevoja për furnizim është rreth 500 ton lëndë djegëse në ditë, pasi sasia prej rreth 500 ton të tjera do të shërbejë si rezervë kontigjence për garantimin e vijueshmërisë së prodhimit.

Si rrjedhojë, lind nevoja e sigurimit të një kapaciteti ruajtës të lëndës djegëse me qëllim sigurimin e vijueshmërisë së furnizimit me lëndë djegëse në vendin e përdorimit dhe të prodhimit nga aseti termik.

Ndërkohë lënda djegëse e kërkuar për furnizim, është lëndë e cila nuk prodhohet në vend apo gjendet lehtësisht brenda vendit, për shkak të sasisë së përcaktuar të sqfurit.

Zinxhiri i furnizimit nga importi i lëndëve hidrokarbure është i rregullt por i ndikuar nga kushtet gjeopolitike botërore, gjë e cila mund të sjellë efekte edhe në periudhat e furnizimit dhe garantimin e furnizimit.

Ndërkohë regjimet e shfrytëzimit të asetit termik janë të varura tërësisht nga konsumi, çmimet e tregjeve si dhe aftësia gjeneruese e aseteve të tjera gjeneruese të KESH sh.a.

Si rrjedhojë regjimet e prodhimit të parashikuara janë të tilla që të përshtaten me sezonalitetin e prodhimit hidrik por edhe sezonalitetin e çmimeve të energjisë në Evropë.

Referuar kapacitetit depozitues në PIA, nevojave për gjenerim energjie elektrike, si dhe në përputhje me kushtet e tregut, sasi të lëndës djegëse të nevojshme për përdorim, janë të ndryshme në periudha të ndryshme të vitit.

Bazuar në parashikimet e Ligjit Nr.9231, datë 13.5.2004 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së koncesionit të formës "BOO" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës" nga ana e shoqërisë me qëllim zbatimin e parashikimeve ligjore dhe të drejtave të fituara me ligj nga subjekt, është realizuar procedura e prokurimit të shërbimit të "Depozitim dhe ngarkim shkarkim i lëndës djegëse në vendin e depozitimit (në PIA) për TEC lundrues".

Bazuar për sa më sipër, nga ana e grupit të punës, më poshtë përcaktohen kërkesat për nevojën e furnizimit me lëndë djegëse për TEC Lundrues, Vlorë.

3. LËNDA DJEGËSE, MËNYRA DHE VENDODHJA E FURNIZIMIT

Për qëllime të funksionimit, këto asete termike kanë nevojën e furnizimit me lëndë djegëse të llojit HFO, përcaktuar në bazë të specifikimeve teknike dhe në referencë të ISO 8217, si ISO RME, me përmbajtje të sqfurit jo më të madhe se 0.5%, si dhe sasi të vogla të lëndës djegëse hidrokarbure LFO. (siç është specifikuar në **Aneksin 1 të këtyre termave**).

KESH nuk do të pranojë propozime për lëndë djegëse të ndryshme nga ajo e kërkuar, me parametra të ndryshëm nga cfarë është parashikuar dhe që nuk bie nën asnjë klasifikim të standarteve ndërkombëtare të cituara apo të ngjashme.

Sasia e kërkuar e Lëndës Djegëse është 21.000 metric ton.

Furnizimi me lëndë djegëse pranë PIA-s i dy termocentraleve lundruese të stacionuara sipas hartës treguese në **Aneksin 2**. Në këtë vendndodhje është pozicionuar gjithë infrastruktura e nevojshme pritëse e lëndës djegëse e gatshme për përdorim.

Operatori fitues duhet të furnizojë lëndën djegëse në vendin e parashikuar në **Aneksin 2** nëpërmjet mjeteve të përshtatshme për transportin e kësaj lënde. Transporti i lëndës djegëse duhet të realizohet në mënyrë të tillë që të mos humbin karakteristikat e lëndës, të mos krijojnë ndotje mjedisore dhe të përmbushi të gjithë legjislacionin shqiptar për transportimin e lëndëve

djegëse. Lënda duhet të transportohet me mjete lundruese të projektuara për transportin e lëndës së kërkuar, me peshë deri në 25.000 tone / lende djegëse dhe thellësi zhytje jo me te madhe se 8 metra. Infrastruktura pritëse e ndërtuar ka kapacitet shkarkimin e 1 mjeti lundrues (siç është treguar në Aneksin 2). Detajet e tjera në lidhje me logjistikën e shkarkimit në vend do të bëhen të ditura pas finalizimit të kontratës me operatorin fitues.

4. LIDHJA DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kontrata do t'i akordohet operatorit që do shpallet fitues në përfundim të procesit të vlerësimit nga ana e KESH sh.a referuar kritereve kualifikuese dhe çmimit për njësi të produktit. (të përshkruara në dokumentin *Kritere për Kualifikim*). KESH do të lidhë kontratë me vetëm 1 operator ekonomik

KESH nuk do mbajë asnjë përgjegjësi dhe kosto ndaj operatorëve që nuk klasifikohen si fitues në përfundim të procedurës së prokurimit.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë nga momenti i nënshkrimit (jo më vonë se 05 Shtator 2024) deri në 05 Nëntor 2024. Data e nënshkrimit të kontratës (jo më vonë se 05 Shtator 2024) do të konsiderohet si datë efektive e fillimit të kontratës. Afati i lëvrimit është 30 ditë nga lëshimi i LC për pagesë.

KESH nuk do të pranojë biofuel apo produkte me karakteristika të ndryshme nga produkti i përshkruar në pikën 3 (Aneksi 1) të materialit.

5. DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË OPERATORIT FITUES

- Ka detyrimin të sigurojë produktin sipas të gjitha kërkesave të këtij dokumenti pa pretendime apo ndryshime
- Ka detyrimin të disponojë të gjithë lejet dhe licencat e nevojshme
- Ka detyrim të përmbushë të gjitha kushtet mjedisore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe kërkesave kombëtare.
- Ka detyrim të tregojë gatishmërinë për të komunikuar në lidhje me porositë gjatë fundjavave dhe ditëve të pushimit si dhe gatishmëri 24 orë gjatë momenteve të furnizimit në vend.
- Ka detyrim të paraqesë të gjithë informacionin e nevojshëm që do kërkohet nga KESH sh.a në lidhje me origjinën e produktit, mënyrën e përpunimit dhe/ose transportit. Kjo për arsye të përmbushjes së kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Ka detyrim të lejojë KESH që të realizojë të gjithë proceset e nevojshme të kampionimit, kontrollit të cilësisë dhe gjithë procedurat e nevojshme për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe të produktit të ofruar.
- Ka detyrim të përmbushë çdo term të parashikuar në këto dokumente tenderi pa i modifikuar, përshtatur apo neglizhuar.
- Ka detyrim të garantojë lidhjen me pikën e shkarkimit të lëndës djegëse.

- Ka detyrim të garantojë respektimin e rregullave teknike dhe të sigurisë përgjatë transportit të lëndës dhe shkarkimit të saj në vendin e përdorimit;
- Ka detyrim të garantojë sigurimin e impaktit në mjedis përgjatë procesit të transportit kur dërgesa ka destinacion furnizimin e Autoritetit kontraktor.
- Të përmbushë të gjitha kërkesat teknike të parashikuara në pikën 3 të këtyre dokumenteve.

6. MËNYRA E OFERTIMIT, SASITË DHE SKEDULI I NGARKESËS

Sasia do të sigurohet dhe lëvrohet me një ngarkesë të vetme sipas sasisë se përcaktuar në pikën 3.

Operatorët ekonomik që do të klasifikohen si të suksesshëm për plotësimin e kriterëve të kualifikimit (*dokumenti Kriteret e Kualifikimit*) duhet të ofertojnë nëpërmjet metodologjisë së mëposhtme:

- Për lëndën djegëse çmim bazë /ton reference të ditës së Njoftimit të gatishmërisë (Notice of Readiness, NoR) të transportuesit të lëndës S&P Platts Global / Commodities / Marine Fuel Oil 0.5%. Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo me tepër se 0.5 % ndaj peshës CIF MED (Marine Residual Fuels, RME)
- **Premio_1 / ton** nëpërmjet së cilës duhet të mbulohen të gjitha shpenzimet për transportin, dhe/ose depozitimin, dhe/ose ngarkim – shkarkimin e lëndës, dhe/ose fitime/ shpenzime operacionale etj.

Pagesa totale që KESH do paguajë për këtë produkt është:

Pagesa totale / ton = S&P Platts CIF Med / ton + Premio_1 / ton

KESH sh.a nuk do të paguajë asnjë kosto shtesë në lidhje me produktin e marrë.

6.1. Kushtet e Shërbimit

Lidhur me çmimin e produktit të kërkuar, bazuar në praktikat brenda vendit, parashikohet që çmimi të jete i formuar nga një reference ne tregjet ndërkombëtare, të cilit i shtohet një çmim Premium.

Pjesëmarrësit do te garojnë mbi çmimin Premium. Çmimi i referencës, bazuar ne praktika, do te jetë ai i referuar Platts Marine fuel oil 0,5% CIF Med.

Për sa i përket çmimit të referencës të furnizimit në vendin e depozitimit, parashikohet të jetë ai i ditës së Njoftimit të gatishmërisë (Notice of Readiness, NoR) të transportuesit të lëndës për ta depozituar ate.

Tabela përmbledhëse e produktit të kërkuar:

1. Furnizim pranë PIA

No.	Key terms	Comments
1	Date of Supply	TBA
2	Buyer	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (Albanian Power Corporation). A State owned, Joint stock company
3	Product / Grade	Max 0.5% Sulfur RME 180 ctss as per attached specs.
4	Incoterm	CIF Petrolifera Italo Albanese, Vlore, Albania. Title, property, and risk shall pass from Seller to supplied party as the oil passes the transport permanent flange connection with PIA.
5	Delivery Date Range	Delivery as defined in Article 4
6	Quantity on Delivery / Tolerance	21 kt / +/- 2% in one lot
7	Price and Reference	CIF Mediterranean Marine Fuel 0.5% cargo (MFCMM00) of NoR issuing day quotation as published by Plats plus a premium of X /mt.
8	Payment Terms	Irrevocable non transferable LC issued by a commercial bank registered in Albania, payable upon presentation of documents (ref Annex 3 - Draft LC containing minimum but non exhaustive criteria)
9	Payment Security:	As per point 8
10	Period of Supply	Q3 2024
11	Inspector/Inspection Cost	Delivery inspection to seller
12	Unloading	After Certificate of compliance with the fuel specifications, issued by an international reputable surveyor / inspector. Duration TBD

13	Testing	Sampling on board of ship Expected certificate 36 hours after sampling
14	Demurrage rate	TBA under negotiation
15	Daytime and demurrage calculation	TBA under negotiation
16	Law & Dispute Resolution	TBA under negotiation
17	Contract terms and conditions	World Bank standards Fuel Supply agreement for power stations.

7. QËLLIMI

Nëpërmjet procedurës së prokurimit kërkohet të sigurohet lëndë djegëse sipas nevojës për përdorim nga TEC Lundruës, e cila do të dorëzohet në vëndin e depozitimit (PIA) në një ngarkesë të vetme.

7.1. Karakteristikat e shërbimit

- Furnizimi

Furnizimi do të realizohet sipas llojit të përcaktuar në këtë dokument.

Furnizuesi duhet të përdorë transportin ujqor për realizimin e furnizimit në depozita.

Furnizimi do të jepet sipas përcaktimit nga autoriteti kontraktor.

7.2. Forma e ofrimit e kërkuar

Për furnizimet e kërkuara, propozohet që oferta të kërkohet bazuar në veprimtarinë e realizuar, furnizim në vëndin e depozitimit:

1. Furnizim ne vëndin e depozitimit, për lëndën djegëse reference RME 180 ccts, sipas ISO 8217. Çmimi i ofruar në Cmim refernce Marine Fuel oil 0.5% Squfur, CIF Med, Platts i ditës së NoR plus Cmimi Premium i ofruar. Ne USD/Ton.
2. Çmimi me i ulet i ofruar nga operatorët e kualifikuar do të shërbejë si bazë për përzgjedhjen e kontraktorit fitues.

Autoriteti Kontraktor mund te tërhiqet ne cdo moment nga negocimi i kontratës pa u përballur me pretendime nga ana e shitësit.

Zgjidhje e njëanshme e kontratës së furnizimit nga Autoriteti kontraktor parashikohet kur nga ana e palës furnizuese nuk respektohet afati i furnizimit, në menyre të përsëritur, kur cilësia e lëndës djegëse nuk është ajo e kërkuar, apo kur pala kontraktore me faj nuk përmbush detyrime te tjera kontraktore.

Për vonesa aplikohen penalitetet sipas ligjit si dhe dëmet e tjera të llogaritura në energji, sipas kontratës reference për kushtet e e vecanta të Bankës Botërore.

8. DOKUMENTACIONI TEKNIK

Operatori duhet të sigurojë dokumentacion se disponon kapacitete teknike, ligjore dhe ekonomike që të ushtrojë veprimtarinë e kërkuar.

Në veçanti në aspektin teknik është e nevojshme që të deklarojë dhe sigurojë dokumentacion për të vërtetuar se ushtrojnë veprimtari në përputhje me kërkesat për sigurisë teknike, të shëndetit dhe sigurisë mjedisore.